



Datë: 14.04.2025
Numër Protokolli: 2704/2025

A.nr.2056/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Ylber Fetahaj në cilësi të procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.2056/2024, të datës 19.12.2024, të parashtruar nga ankuesja G.L, kundër organit të punësimit: Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*Masë disiplinore*”, në pajtim në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.2056/2024, e datës 19.12.2024, e parashtruar nga ankuesja G.L, ashtu që **shfuqizohet** Vendimi me numër protokolli 730/24-13/B, i datës 18.11.2024, i Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, ndërsa, lënda kthehet **në rishqyrtim dhe rivendosje** te organi i njëjtë.

II. Obligohet Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në piken I të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, G.L (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), e punësuar në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës, më datë 19.12.2024 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 730/24-13/B, të datës 18.11.2024, të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës. me të cilin akt të njëjtës i është shqiptuar masa disiplinore: “*Ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë një (1) vjeçare*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave,

ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 16.01.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës në çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit*) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 6941 të datës 19.12.2024, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Vendimin me numër protokolli 730/24-13/B të datës 18.11.2024; Raportin e ndërprerjes së përkohshme të punës të datës 05.05.2024; Kërkesën me numër protokolli 680/24-101/B të datës 14.10.2024; Vendimin për pushim të datës 05.07.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 16.01.2025; Akt emërimit me numër protokolli 664/23-07/B të datës 29.12.2023; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 04.01.2024; Vërejtjen me shkrim me numër protokolli 733/24-10/B të datës 18.11.2024; E-main e datës 05.11.2024; E-mailin e datës 11.10.2024 së bashku me bisedat elektronike (wave travel) dhe fotografi nga celulari; Procesverbalet e datës 06.11.2024; Procesverbal i datës 08.11.2024; Vendimin me numër protokolli 660/24-06/B të datës 03.10.2024; Akt emërimit me numër protokolli 110/13 të datës 27.05.2013; Akt emërimit me numër protokolli 327/23-07/B të datës 20.07.2023; Akt emërimit me numër protokolli 279/19-06/B të datës 01.10.2019;

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në ***ri-shqyrtim*** dhe ***rivendosje të organi i njëjtë, sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt emërimit me numër protokolli 664/23-07/B të datës 29.12.2023, është e punësuar në pozitën e punës *Inspektore Hetuese e Konkurrencës* në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës.

Tutje nga shkresat e lëndës, rrjedh se U.D Udhëheqësi i Divizionit për Marrëveshje të Ndaluar i Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, pas pranimi të shkresës elektronike zyrtare të datës 11.10.2024, të parashtruar nga Drejtori i Përgjithshëm i organit përkatës, në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses me datë 14.10.2024, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses, nën supozimet për shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara sipas nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, paragrafi 4 nën paragrafët 4.1, 4.6, 4.7 dhe 4.20 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Komisioni Disiplinor i organit përkatës të punësimit, me Vendimin me numër protokolli 730/24-13/B, të datës 18.11.2024, ka konstatuar se ankuesja me veprimet e saj është përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore gjegjësisht për shkelje të rregullave të përcaktuara në kodin e etikës, të përcaktuar sipas nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, rrjedhimisht të njëjtës i shqipton masën disiplinore “*Ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë një (1) vjeçare*”, sikurse përcaktohet me nenin 57 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të këtij Ligji.

Kundër Vendimit numër protokolli 730/24-13/B, të datës 18.11.2024, të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore së vendimi i kontestuar është nxjerr përmes shkeljes dispozitave të procedurës së përgjithshme administrative dhe ligjit për Zyrtarët Publik dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, për çka e njëjta kërkon që të aprovohet në tërësi ankesa dhe të anulohet vendimi i kontestuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me çështjen e kontestuar iu referuar dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht :

- Nenit 55 paragrafi 1, i cili përcakton se: *1. Nën punësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim;*
- Nenit 56 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, paragrafin 2 si dhe paragrafin 4 nën paragrafin 4.6, ku përcaktohet se: *1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.6 shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës;*
- Nenit 57 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 ku përcaktohet se: *2. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të rënda janë: 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite;*
- Nenit 58 paragrafin 2, ku përcaktohet se: *2. Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor;*
- Nenit 59, ku përcaktohet se: *1. Procedura disiplinore fillon mbi bazën e dyshimit të bazuar për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil, duke mos përjashtuar informatat e pranuar në mënyrë anonime. 2. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil. 3. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 3.1. me kërkesë të mbikëqyrës/it të drejtpërdrejtë të nëpunës/it civil; 3.2. bazuar në të gjeturat dhe/apo rekomandimet e çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtareje/i tjetër brenda institucionit, si dhe me kërkesën e qytetares/it;.....si dhe*
- Nenit 61, paragrafin 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Për përcaktimin e masës disiplinore mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 62 të këtij ligji; 1.4. përprjekjet e mëparshme të nëpunës/it për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore shqiptohen në raport të drejtë me shkeljen e kryer.*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i vendimit kontestues, konstaton se ankuesja nga Komisioni Disiplinor është shpallur përgjegjëse për shkelje të kodit të etikës, për shkak se e njëjta më datë 05.07.2024 ka munguar në punë me arsyetimin se gjendja e saj shëndetësore nuk e ka lejuar të vijë në punë, duke bashkangjitur edhe dëshminë mjekësore, mirëpo që e njëjta në periudhën e lejes së pushimit mjekësor ka qenë në bregdetin e Shqipërisë, duke vepruar në kundërshtim me qëllimin dhe natyrën e lejes mjekësore, rrjedhimisht Komisioni ka konstatuar se ankuesja me këtë rast ka bërë deklaram të rrejshëm dhe keqpërdorim të dëshmisë mjekësore për përfitim të pushimit pa të drejtë, duke theksuar ndër të tjera veprimi i tillë abuziv ndaj dëshmise mjekësore krijon precedent të rrezikshëm dhe nuk mund të tolerohet.

Andaj, Kolegji i Këshillit, referuar rrethanave që kanë rezultuar me shkelje disiplinore të ankueses sipas vendimit kontestues të Komisionit Disiplinor, i'u referua Rregullores në fuqi Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik, gjegjësisht nenit 11, është përcaktuar se: *1. Zyrtari publik në rast të sëmundjes ka të drejtë për pushim mjekësor në kohëzgjatje deri njëzet (20) ditë punë brenda një (1) viti me kompensim 100% të pagës. 2. Zyrtari publik i cili e shfrytëzon pushimin mjekësor, duhet të informoj mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë dhe të ofrojë dëshminë përkatëse nga organi kompetent mjekësor.... 5. Dëshmi nga organi kompetent mjekësor, sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, nënkupton dëshminë e cila përcakton qartë ditët e mungesës në punë për shkak të gjendjes së tij mjekësore. 6. Pas kalimit të periudhës me kompensim, sipas paragrafit 1 dhe 3 të këtij neni, zyrtari publik me rekomandimin e organi kompetent mjekësor ka të drejtë të vazhdojë pushimin mjekësor pa pagesë, rrjedhimisht nisur nga ky përcaktim ligjor rezulton se ankuesja ka ofruar dëshminë mjekësore apo Raportin e Ndërrerjes së Përkohshme të Punës, të lëshuar më datë 05.05.2024, nga Qendra Kryesore e*

Mjekësisë Familjare IV në Prishtinë, mirëpo në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit kjo dëshmi është kontradiktore apo kundërthënëse në vete vetë, ngase sipas përshkrimeve në këtë dëshmi datat janë në kundërshtim njëra me tjetrën gjegjësisht nga ana e saj e majtë rezulton për pengesë të plotë për punë prej datës 05.07.2024 deri 05.05.2024, ndërsa tek dita e parë dhe e fundit e ndërprerjes është paraqitur data 05.05.2024, sikurse e njëjta datë ajo 05.05.2024 është shkruar në datën e lëshimit të kësaj dëshmie.

Rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Komisioni Disiplinor i organit përkatës të punësimit paraprakisht duhet të verifikojë vërtetësinë e dëshmisë së bashkangjitur nga ankuesja, gjegjësisht të verifikojë se a kemi të bëjmë me lëshim teknik nga ana e organit kompetent i cili e ka lëshuar Raportin e Ndërprerjes së Përkohshme të Punës, përmes së cilës ankueses më datë 08.07.2024 Drejtori i Përgjithshëm, i ka aprovuar kërkesën e pushimit mjekësor për datën 05.07.2024, dhe më tej sipas vërtetësisë së saj dhe vlerësimit të gjendjes shëndetësore të ankueses nga organet kompetente të shëndetësisë të konstatoj supozimet dhe të veprojë në proporcion mbi shkeljet e pretenduara nga ankuesja. Po ashtu Komisioni Disiplinor është i obliguar që në rivendosje të vërtetojë sakte kush ka qene mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankueses në kohën kur pretendohet shkelja dhe gjithashtu i njëjti të marr parasysh edhe veprimet apo mos veprimet e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses me rastin e shkeljes se pretenduar sepse ne baze të shkresave të lëndës, i njëjti është vënë në dijeni lidhur me shkeljen e supozuar që nga data 11.07.2024, ndërsa inicimi i procedurës disiplinore është bërë me datë 14.10.2024. Gjithashtu Komisioni disiplinor të shqyrtojë dhe vërtetojë se në ditën kur ka munguar ankuesja a e ka njoftuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë dhe po ashtu të shqyrtojë pretendimet e ankueses se e njëjta gjatë periudhës paraprake të vitit 2024 a e ka realizuar të drejtën e pushimit vjetor dhe nëse jo Komisioni të vlerësojë se pse i është refuzuar kjo e drejtë e garantuar me dispozitat ligjore.

Theksuar si më sipër për shkak të mos vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, apo verifikimit të vërtetësisë së provave të cilat kanë qenë vendimmarrëse dhe marrjes parasysh edhe të deklaratave të ankueses nga Komisioni Disiplinor, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të shfuqizoj Vendimin me numër protokolli 730/24-13/B, të datës 18.11.2024, të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, dhe çështjen të kthej në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, me detyrimin që ky i fundit në ri procedurë të veprojë sipas pikëpamjeve juridike të dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, duke eliminuar fillimisht shkelje e konstatuar si në arsyetimin e këtij vendimi si dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim të plotë me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.2056/2024

Ylber FETAHAJ

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses G.L;
- Udhëheqëses të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës;
- Komisionit Disiplinor në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.